REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 3 gusht 2020
Nr. Ref.:RK 1591/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI41/20

Parashtrues

Shaqir Krasniqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [C. nr. 865/09] të 16 majit 2016 të Gjykatës Themelore në Gjakovë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Shaqir Krasniqi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Gjakovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [C. nr. 865/09] të 16 majit 2016 të Gjykatës Themelore në Gjakovë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Themelore, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 25 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

6. Më 28 shkurt 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.

7. Më 17 mars 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës.

8. Më 27 maj 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga dokumentet që gjenden në kërkesë, rrjedh se parashtruesi i kërkesës, në cilësi të blerësit, më 14 nëntor 1991, lidhi kontratën për shitblerjen e banesës në pronësi shoqërore me "Gorenje Elektromotori a.d." në cilësi të shitësit, e cila është legalizuar në Gjykatën Komunale në Gjakovë më 31 dhjetor 1991. Sipas kësaj kontrate, blerësi ishte dashur të paguante për apartamentin për 38.5 vjet, ndërsa palët, ndër të tjera, ranë dakord që nëse blerësi nuk paguan tre (3) këste mujore të njëpasnjëshme, shitësi ruan të drejtën e ndërprerjes së njëanshme të

kontratës. Parashtruesi i kërkesës - blerësi deri në vitin 1999 ka paguar rregullisht këstet mujore, por nga viti 1999 deri më 4 janar 2016, deri në ditën e vërtetimit të gjendjes faktike në gjykatë nuk ka paguar asnjë këst.

10. Në një datë të paspecifikuar, "Gorenje Elektromotori sh.a", në cilësinë e shitësit, parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore dhe kërkoi që të ndërpresë kontratën për shitjen e banesës me parashtruesin e kërkesës, me arsyetimin se ky i fundit kishte dështuar të paguante detyrimin e dakorduar ashtu siç përcaktonte kontrata.

11. Më 16 maj 2016, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 865/09] duke u bazuar në nenin 17 dhe 124 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të 30 marsit 1978 të RSFJ-së, vendosi që "Gorenje Elektromotori sh.a" e ka të drejtën e ndërprerjes së njëanshme të kontratës pasi parashtruesi i kërkesës nuk kishte respektuar procedurën e pagesës siç parashikohej në kontratën e lidhur midis tyre.

12. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata Themelore ka sqaruar:

> *"Sipas bindjes së kësaj gjykate pretendimet e palës paditëse, janë të bazuara pasi që në tërësi u vërtetua se paditësi dhe e paditura kanë lidhur kontratë për shitblerjen e banesës në pronësi shoqërore sipas të cilës kontratë në mes tjerash në pikën **III** të Kontratës janë marrë vesh për çmimin e shitblerjes së banesës si dhe afatin se deri kur do të paguhet çmimi në emër të shitblerjes se banesës. Në rastin konkret çmimi i shitblerjes së banesës ka qenë dashur të paguhet me kiste në afat prej 38.5 vite, ndërsa i padituri që nga lidhja e kontratës e deri ne vitin 1999 i ka paguar kistet me rregull ndërsa nga viti 1999 e ka ndërprerë pagesën e kisteve në emër të blerjes së banesës. Andaj në rastin konkret paditësi sipas nenit **VIII** të kontratës Leg.nr.4981/91, të dt. 31.12.1991, ka të drejtë se nëse blerësi këtu i padituri nuk paguan tri (3) kiste mujore radhazi nga pika **III** e kontratës, shitësi e ka rezervuar të drejtën që në mënyrë të njëanshme të shkëputë kontratën, andaj edhe gjykata vendosi si nën **I** të këtij aktgjykimi."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [C. nr. 865/09] i 16 majit 2016 i Gjykatës Themelore është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të përcaktuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

14. Më tutje, parashtruesi i kërkesës pohon se *"ka fituar pronësinë mbi atë pronë me parashkrim"*.

15. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Themelore.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

17. Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

18. Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç parashikohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], që parasheh:

> Neni 47
> [Kërkesa individuale]
>
> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
>
> *2. Individi mund ta ngrit kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

19. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës, që specifikon:

> *"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*
>
> *[...]*
>
> *(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar."*

20. Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari duhet të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive që janë të disponueshme në pajtim me ligjin, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.

21. Në këtë mënyrë, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të korrigjojnë gabimet e tyre përmes procedurave gjyqësore të rregullta para se rasti të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion në lidhje me shkeljen e pretenduar, pavarësisht nëse dispozitat e KEDNJ-së janë inkorporuar në të drejtën nacionale apo jo (shih, *inter alia, Aksoy kundër Turqisë,* paragrafi 51 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 18 dhjetorit 1996).

22. Parimi është se mekanizmi mbrojtës i krijuar nga Gjykata Kushtetuese të jetë subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor që mbron të drejtat e njeriut (shih, *inter alia, Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar,* paragrafi 48 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 7 dhjetorit 1976).

23. Në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të ketë një rrugë të rregullt deri te mjetet juridike të cilat janë të disponueshme dhe të mjaftueshme për të siguruar një mundësi për të korrigjuar shkeljet e pretenduara. Ekzistimi i mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaft i sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dhe nëse nuk është kështu, atëherë këtyre mjeteve juridike do t'iu mungojë disponueshmëria dhe efektiviteti i nevojshëm (shih, *inter alia, Vernillo kundër Francës,* paragrafi 27 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 20 shkurtit 1991, *dhe Dalia kundër Francës,* paragrafi 38 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 19 shkurtit 1998).

24. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse mjetet juridike janë shteruar dhe nëse mjeti juridik ishte efektiv, në dispozicion në teori dhe praktikë në kohën përkatëse, përkatësisht, që ka qenë i qasshëm, që ka mundur t'i korrigjojë shkeljet në lidhje me kundërshtimet e parashtruesit të kërkesës, dhe gjithashtu ka ofruar një perspektivë të arsyeshme për sukses (shih, *inter alia, Civet kundër Francës,* paragrafët 42-44 të Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 28 shtatorit 1999).

25. Megjithatë, në rastet kur mjeti juridik parashikohet me ligj, i takon parashtruesit të kërkesës të provojë që mjeti juridik i parashikuar me ligj ishte shteruar më të vërtetë apo për ndonjë arsye ishte i padisponueshëm dhe joefektiv në rrethanat konkrete të çështjes, apo kanë ekzistuar rrethanat e veçanta për shkak të të cilave ai ose ajo ishte liruar nga kushtet e shterimit të mjeteve juridike.

26. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kundër Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C. nr. 865/09, të 16 majit 2016, ekziston mundësia e ushtrimit të ankesës, si mjetit efektiv juridik kundër Aktgjykimit të kontestuar, e cila është theksuar nga Gjykata Themelore në udhëzimin juridik, ku thuhet se *"kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate"*, gjë që parashtruesi i kërkesës nuk e bëri në rastin konkret.

27. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme, për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar mjetet e rregullta juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës,

nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, më 27 maj 2020, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJE këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJE këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Bajram Ljatifi

Arta Rama-Hajrizi